



Funded by  
the European Union



Datë, 8 maj 2024

## TERMA REFERENCE

### SHËRBIMI I KËRKUAR: EKSPERTIZË PËR REALIZIMIN E NJË RAPORT MONITORIMI

#### 1. HYRJE

**FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFËSI TË KUFIZUARA (FSHDPAK)** është një organizatë shqiptare jofitimprurëse, themeluar nga OXFAM GB në vitin 1996. Programet e FSHDPAK, synojnë të rrisin shanset e personave me aftësi të kufizuara për t'u integruar në jetën sociale, ekonomike, politike e kulturore të vendit, përmes respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të tyre. Që nga krijimi, FSHDPAK ka funksionuar si qendër koordinimi për ndërmarrjen e nismave më madhore me ndikim në përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Për të përmbushur misionin tonë, ne punojmë së bashku me dhe pa aftësi të kufizuara.

#### 2. INFORMACION MBI SHËRBIMIN E KËRKUAR

Fondacioni shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (FSHDPAK), së bashku me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), Fondacionin Down Syndrome Albania (DSA) ka filluar zbatimin e projektit "Qasje gjithëpërfshirëse për të garantuar akses të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri", financuar nga Bashkimi evropian.

Objektivi kryesor i projektit është fuqizimi i rolit dhe kapaciteteve të organizatave mbrojtëse të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për t'u angazhuar efektivisht në forcimin e kuadrit ligjor për rritjen e aksesit në drejtësi dhe barazisë përpara ligjit për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet ndikimit në sistemin e një drejtësie miqësore, institucioneve të drejtësisë të aksesueshme, procedurave të aksesueshme dhe ndihmës ligjore falas të aksesueshme dhe efektive.

Në kuadër të këtij projekti do të realizohet një raport monitorimi gjithëpërfshirës mbi njohjen e barabartë para ligjit dhe aksesin në drejtësi, duke përfshirë aksesin në ndihmë juridike falas për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri, përputhjen e legjislacionit me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) dhe standardeve më të mira të BE-së. Raporti do të realizohet si domosdoshmëri edhe e rekomandimeve që Komiteti i KDPAK ka dhënë për shtetin Shqiptar pas paraqitjes së raportit të qeverisë për zbatimin e KDPAK, i cili kërkon nga shteti që të marrë masa për harmonizimin e legjislacionit dhe praktikave për "Qasjen në drejtësi" (neni 13) dhe "Barazia përpara Ligji" (neni 12) me Konventën. Monitorimi do të synojë institucione si, Ministria e Drejtësisë, gjykatat e të gjitha niveleve, Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, qendrat e ndihmës juridike parësore, klinikat e ligjit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, avokatët, noterët, prokuroritë etj. Pjesë e studimit do të jenë edhe persoant me aftësi të kufizuara në 5 rrethet e synuara nga projekti, si dhe raporti i aksesueshmërisë së auditimit.



Funded by  
the European Union



Down Syndrome  
Albania



### 3. PERIUDHA E SHËRBIMIT TË KËRKUAR

Shërbimi do të ofrohet gjatë periudhës 30 Maj – 30 Shtator 2024 dhe do të konsistojë në 19 ditë pune.

### 4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Realizimi i një vlerësim të politikave, legjislacionit dhe praktikave të disponueshme për të garantuar barazinë para ligjit dhe aksesin në drejtësi, duke përfshirë ndihmën juridike falas për personat me aftësi të kufizuara;
- Mbledhja e të dhënave cilësore dhe sasore nga institucionet përgjegjëse për aksesin e personave me aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë aksesin në ndihmë juridike falas si dhe nivelin e njohjes së barabartë përpara ligjit të garantuar nga kuadri ligjor si dhe nëpërmjet rregullave, procedurave dhe masave praktike.
- Mbledhja e të dhënave cilësore dhe sasore nga 250 persona me aftësi të kufizuara në Tiranë, Gjirokastrë, Fier, Shkodër, Korçë.
- Propozimi i rekomandime për të adresuar nevojat dhe mangësitë e identifikuara nëpërmjet një udhërfyesi.

### 5. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Të ketë mbaruar fakultetin e drejtësisë dhe master shkencor apo profesional në drejtësi ose në një fushë të ngjashme me të;
- Të ketë eksperiencë mbi 10 vjet në fushën e kërkuar, në aspekte të ndryshme të mbrojtjes dhe advokimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
- Të njoh standardet ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, legjislacionin shqiptar në këtë fushë si dhe të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.
- Të ketë eksperiencë të mëparshme në realizimin e studimeve, manualeve, udhëzuesve apo raporteve me fokus të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme angazhimi me organizata të shoqërisë civile;
- Të zotërojë aftësi shumë të mira komunikuese, analitike etj ;
- Të jetë bashkëpunues/e, me qasje pozitive dhe etikë profesionale.

### 6. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Curriculum Vitae;
- Letër motivimi;
- Ofertë financiare për shërbimin e kërkuar.

**Adresë elektronike:** Materialet do të dërgohen në adresën e e-mailit [info@adrf.al](mailto:info@adrf.al)

**Adresë postare:** Rruga e Bogdanëve, Tiranë, Shqipëri



Funded by  
the European Union



Down Syndrome  
Albania



## 7. AFATET

**Afati për dërgimin e aplikimeve:** Afati I fundit për dërgimin e aplikimeve është data 23 Maj 2024.

**Njoftimi i aplikantëve:** aplikantët që përmbushin kriteret e mësipërme do të njoftohen me email dhe do të ketë mundësi për tu intervistuar nga stafi i projektit.